



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENSIONI KOSOVAR kundër KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI – CORRUPTION AGENCY

Nr. II

RAPORT PËR MEDIA

PRISHTINË 06 PRILL 2009 - Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit, gjatë vitit 2008, konform legjislacionit në fuqi, i ka hetuar me shumë seriozitet të gjitha informatat e pranuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Kësisoj, në të gjitha rastet për të cilat gjatë hetimeve kemi arritur të grumbullojmë provat e nevojshme me të cilat provohej përgjegjësia për veprat penale me natyrë korruptive të personave përgjegjës, i kemi proceduar në prokuroritë publike kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm.

Mirëpo praktikisht, Agjencioni gjatë punës së përditshme ka hasur edhe në veprime abuzive të cilat nuk mund të ndjeken penalisht për shkak se më tepër paraqesin shkelje etike se sa vepër penale të paraparë me Kodin penal të Kosovës.

Pavarësisht kësaj, ne të gjithë e dëshirojmë që Kosova të jetë një shtet ku sundon ligji dhe ku dukuria e korrupsionit ku do që shfaqet të luftohet ashpër nga të gjithë mekanizmat relevant institucional dhe ku ndërtohet një shoqëri me integritet të lartë.

Veprimet e poshtëshënuara, AKK i gjykon dhe dënon në aspektin moral, njëkohësisht i cilëson ato si jo-etike dhe të dëmshme për rrugën e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë dhe të pa korruptuar. Në shenjë të demonstrimit të pakënaqësisë sonë për veprimet e tilla i prezantojmë disa raste konkrete, por për shkak të ruajtjes së besueshmërisë së burimit dhe për shkak se rastet janë në procedurat hetimore, jemi të detyruar t'ju shmangemi të dhënave personale të atyre që pretendohen se kanë qenë të përfshirë në këto veprime abuzive.

- Në një ndërmarrje publike janë suspenduar të gjithë zyrtarët e auditimit të brendshëm, pasi që ata i përcjellin një raport me parregullsi të mëdha udhëheqësve të ndërmarrjes. Ata ishin suspenduar pa as një vendim, mirëpo kanë vazhduar ti marrin pagat pa punuar as gjë. Suspendimi zgjati rreth 6 muaj

dhe në bazë të një procesverbali ata rikthehen prapë në punë. Udhëheqësit e kësaj ndërmarrje nuk i morën parasysh rekomandimet e raportit të këtyre auditorëve për ti evituar parregullsitë në atë ndërmarrje. Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit konsideron se veprimet e tilla minojnë jashtëzakonisht shumë zhvillimet e ndërmarrjeve publike. AKK kujton se ndërmarrjet publike janë pasuri e tërë shoqërisë, ndërsa u bënë thirrje udhëheqësve të tyre që gjatë menaxhimit të këtyre ndërmarrjeve të mos sillen si të ishte pronë apo biznes privat.

- Në një ministri në fund të vitit 2007 u suspenduan nga puna të gjithë personat që refuzuan të jenë pjesë e keqpërdorimeve të ndryshme. Zakonisht fundi i vitit është periudha në të cilën ndodhin shkeljet më të mëdha ligjore. Pas kalimit të fund vitit, në fillim të vitit 2008 këta zyrtarë prapë janë kthyer në punë. AKK konsideron se veprimet e tilla kultivojnë një frymë negative dhe nxisin zhvillimin e praktikave dhe mendësisë së korruptuar, pasi që krijohet përshtypja se për të mbajtur një pozitë pune është e domosdoshme të involvolesh në kalkulime dhe veprime abuzive.
- Në një ndërmarrje publike zyrtarët e saj në mënyrë masovike i kanë shfrytëzuar automjetet zyrtare për pushime verore në Ulqin. Kësaj praktike nuk i është shmangur as një këshilltar i një Ministri. AKK tërheqë vërejtjen se praktikat e tilla janë shkelje të normave ligjore, dhe rikujton edhe një herë se automjetet zyrtare nuk duhet të shfrytëzohen për aktivitete private nga as një institucion publik.
- Disa zyrtar të një komune për pronësinë e lokaleve të tyre afariste i shfrytëzojnë emrat e personave tjerë. Identifikimi i tyre bëhet vetëm atëherë kur këta pronarë i lëshojnë lokalet me qira. Qira marrësit habiten kur shumën e qirasë fillojnë ta kërkojnë personat që nuk ishin palë kontraktuese. Praktikrat e tilla devijante e përjashtojnë mundësinë e të drejtës së barabartë në tenderime, ngulfasin skajshmërisht transparencën në proceset e tilla, si dhe shkaktojnë humbjen e besimit të publikut në institucionet publike, duke marrë parasysh që përfituesit e pronave të ndryshme nganjëherë bëhen vetë zyrtarët e atij institucioni i cili i shpall procedurat e shitjes së tyre.
- Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit ka vërejtur një fenomen të praktikave abuzive edhe me patundshmëritë e ndryshme të cilat konsiderohet si pronë publike. Në këtë kontekst në disa raste nga pasuria e patundshme në qytete apo edhe vende atraktive (të vlerësuara si pasuri nacionale) janë ndarë parcela tokash ku edhe janë ndërtuar objekte të ndryshme dhe janë regjistruar në emra të ndryshëm ndërsa shfrytëzuesit real janë zyrtarë të lartë institucional.
- Në shumë raste institucionet e ndryshme praktikojnë shpalljen e tenderëve pasi që të kenë përfunduar projektet. Agjensioni ka zbuluar disa raste të tilla dhe ka intervenuar falë bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët. Kjo praktikë është shkelje e rëndë ligjore dhe ndërprerja e saj është nevojë imediate.

- Në një rast gjyqësor gjykatësi lëshon vendim gojor në dëm të një personi që kishte kryer kundërvajtje dhe të njëjtit i shqipton gjobë. Të nesërmen për të njëjtën lëndë, i njëjti gjykatës, merr vendim me shkrim duke e liruar personin sado që aktvendimi verbal është shpallur në prezencën e dy policëve. Dyshohet që shumën e gjobës ta ketë përvetësuar gjykatësi, kurse kryerësi i kundërvajtjes përfiton me vendim lirues duke me qëllim të mos evidentimit të evidencë. (Kundërvajtësi është me punë të përkohshme jashtë vendit). Agjensioni konsideron se praktikat e tilla duhet të ndalen pasi që si pasojë publiku mund të humb besimin në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe dëmtimin e imazhit të gjyqësorit karshi opinionit.
- Një zyrtar i një institucioni e shantazhon një zyrtarë të prokurimit të një institucioni tjetër duke i bërë presion zyrtarit të prokurimit se tenderin në fjalë duhet ta fitojë një kompani e favorizuar, ose në të kundërtën zyrtarit të prokurimit i humbë licenca si zyrtar i prokurimit. Raste të tilla të shantazhimit të zyrtarëve të prokurimit dyshohet të jenë të shumta dhe si pasojë kemi suspendim të shpeshtë të zyrtarëve të prokurimit nëpër institucione. Agjensioni u bënë thirrje të gjitha institucioneve që të jenë transparente në procesin e tenderimit, sepse vetëm përmes frymës së barabarësisë ngrihet vlera e cilësisë së çdo aktiviteti të prokurimit e cila zhvillohet përmes procedurave të tenderimit.
- Deformimet profesionale dhe shkeljet e detyrës po ashtu kanë qenë elemente shqetësuese për AKK-në. Në një rast kur policia kishte në plan që në orët e mëngjesit ti kontrollojë zyrat e personave të dyshimtë për kontrabandë, kontrabandistët ishin informuar paraprakisht dhe i pritën policinë me shprehje nënçmuese se e dinin se në këtë orë policia do ti kontrollonte zyrat e tyre. Kjo hedh dyshime dhe shqetësime për lidhjen në mes të krimit të organizuar dhe zyrtarëve të caktuar nëpër institucione.
- Vendimet për ndryshimin e destinacionit të tokave në mënyrë të jashtëligjshme janë gjithashtu një nga dukuritë shqetësuese. Tokat me destinim bujqësor shndërrohen në toka me destinim ndërtimor në mënyrë tërësisht të jashtëligjshme për të cilën sigurohen përfitime enorme. Ndonëse nga mekanizma të ndryshëm janë adresuar në prokuroritë kompetente rreth 40 denoncime të kësaj natyre, megjithatë as njëri nga ta nuk është trajtuar nga këto gjykatat.